



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës Jugore
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT
Nr. 02-060/01-0021467-7/26 dt. 29.04.2026
Mitrovicë

02-060/01-0021467-7

29.04.2026

Bazuar në nenet 12, dhe 14, të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (GZ Nr. 28, publikuar më 4 qershor 2008); nenin 9 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenin 26 të Rregullores së (QRK) nr. 09/2020, për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, në nenin 13, paragrafi 1, nën paragrafi 1.4 dhe 15 të Statutit të Komunës Nr.02-060/01-0056607/20-4, datë 24.09.2020, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me 29.04.2026 sjell këtë:

VENDIM

Për destinimin dhe shfrytëzim të pronës komunale për nevojat Muzeut të Qytetit Mitrovicës

1. Miratohet Vendimi për destinim dhe shfrytëzimin e pronës komunale për nevojat Muzeut të Qytetit të Mitrovicës, si institucion vartës i Komunës.
2. Prona e paluajtshme komunale sipas pikës 1 të këtij vendimi është në pronësi të Komunës së Mitrovicës së Jugut, Zona Kadastrale Mitrovicë, sipas Certifikatës mbi të Drejtat e Pronës, të lëshuar nga Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë dhe përfshin:
 - 2.1 Objekti “Ish Domi i Armatës”;
 - 2.2 Parcela Kadastrale P-71208072-01600-6, me sipërfaqe prej 1812 m², dhe
 - 2.3 Parcela Kadastrale P-71208072-01600-7, me sipërfaqe prej 2375 m²,
3. Destinimi dhe shfrytëzimi i objektit dhe parcelës së pronës së paluajtshme komunale nga pika 2 e këtij vendimi do të evidentohet në regjistrin e të drejtave pronësore.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi kujdesen Kryetari i Komunës, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë dhe Drejtoria për Planifikim dhe Urbanizëm dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.
5. Vendimi shpallet pesëmbëdhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale dhe hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës së Mitrovicës së Jugut.

Mitrovicë



Kryesuesi i Kuvendit

Safet KAMBERI

Dorëzohet:

- 1 x 1 Kryesuesit të Kuvendit
- 1 x 1 MAPL-së
- 1 x 1 Arkivit
- Kopje: Kryetarit të Komunës
Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë
Drejtorisë për Planifikim dhe Urbanizëm dhe
Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport